



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:250664
Datë: 20.02.2024
Numri i dokumentit: 05347850

C.A.P.nr.774/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Besnik Bislimaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Z. G., nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fatbardh Makolli, avokat me seli në Rr. “T. S.”, nr.15 në Prishtinë, kundër debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), me seli në Prishtinë, për përmbarimin e dokumentit përmbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Cpc.1382/2021, të datës 24.04.2023, më datë 20.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Cpc.1382/2021, të datës 24.04.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin Cpc.1382/2021, të datës 24.04.2023, ka vendosur si në vijim: “I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit Qendra Klinike Universitare (QKUK), me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër aktvendimit mbi caktimin e përmbarimit Cpc.nr.1106/21, i datës 09.06.2022, i marrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë. II. DETYROHET debitori Qendra Klinike Universitare (QKUK), me seli në Prishtinë, që kreditorit Z. G.. nga Prishtina, t’ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore, dhe atë në emër të hartimit të përgjigjes në prapësim shumë prej 117.00 €.”

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor, debitori përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që ta aprovojë ankesën e debitorit ndërsa aktvendimin e ankimuar ta anulojë si të pabazë, të pasafatshëm dhe të palejueshëm pasi që kemi të bëjmë me çështje të gjykuar.

Kreditori përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur përgjigje në ankesë përmes së cilës i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të debitorit duke theksuar se pretendimet e të njëjtit për çështje të gjykuar janë të pasakta pasi që nuk kanë të bëjnë me çështjen e njëjtë prandaj ka propozuar që ankesa e debitorit të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar të vërtetohet në tërësi.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, nenit 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Z. G. nga Prishtina, me datë 29.10.2021, përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur propozim për përmbartim pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega Përmbartimore, kundër debitorit, për lejimin e përmbartimit në bazë të titullit ekzekutiv, Vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-65, të datës 16.03.2021. Gjykata Themelore në Prishtinë duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me anë të Aktvendimit Cpc.1382/21, të datës 15.06.2022 ka caktuar përmbartimin përmes së cilit e ka obliguar debitorin që kreditorit t'ia paguajë shumën prej 2,500.00 €. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Debitori, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, me datë 01.07.2022, ka ushtruar prapësim përmes së cilit e ka kundërshtuar propozimin për përmbartim për shkak se sipas të njëjtit dokumenti mbi bazën e të cilit është iniciuar ky propozim është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore të Procedurës së Përgjithshme Administrative prandaj ka propozuar që prapësim i debitorit të aprovohet si bazuar ndërsa aktvendimi Cpc.1382, i datës 15.06.2022 të anulohet dhe propozimi për përmbartim të hedhet poshtë si i pabazë.

Me përgjigje në prapësim kreditori i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit si të paqëndrueshme duke propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar ndërsa Aktvendimi Cpc.1382, i datës 15.06.2022 të mbetet në fuqi. Ka kërkuar që të obligohet debitori me shpenzime për përpilimin e përgjigjes në prapësim në vlerë prej 156,00 €.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, me aktvendimin e atakuar, ka vendosur që ta refuzojë si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se gjykata, pasi vlerësoi pretendimet e debitorit në prapësim, përgjigjes në prapësim nga ana e kreditorëve, propozimit për përmbarim dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka ardhur në përfundimin se me rastin e caktimit të përmbarimit, dokumenti përmbarues i plotëson të gjitha kushtet ligjore për të shërbyer si bazë juridike dhe titull ekzekutiv për caktimin e përmbarimit, për arsye se dokumenti përmbarues është i përshtatshëm për përmbarim, dihet kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit, ashtu siç përcaktohet me nenin 21, 22 par.1 pika 1.2, 23 par.2, nenit 24 dhe nenit 27 të LPP-së, po ashtu nga vlerësimi i shkresave të lëndës, dhe dokumentit përmbarimor, shihet se kreditorit i ‘u është njohur shuma prej 2,550.00 €, në emër të shpërblimit jubilar për 30 (tridhjetë) vite përvojë pune, me anë të dokumentit të përshtatshëm për përmbarim mbi të cilën është nisur kjo procedurë përmbarimore (*më gjerësisht si në arsyetim të aktvendimit*).

Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave ligjore nga neni 22, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, neni 23, paragrafi 2, neni 24, nenin 27 dhe 73 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP).

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK, prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të kreditorës, Gjykata e Apelit i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme, ngase nuk kanë bazë në prova konkrete.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë duke i vlerësuar pretendimet ankimore të mësipërme të parashtruar nga ana e debitorit, vlerëson se të njëjtat janë të pa bazuara për arsye se kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi për përmbarim është lëshuar në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së dhe atë për faktin se propozimi për përmbarim është bërë në bazë të dokumentit të përmbarues Vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-65, të datës 16.03.2021, pra vendimit administrativ i përcaktuar me nenin 22 par.1 nën par 1.2 të LPP-së, sipas të cilit “*Dokumente përmbaruese janë: 1.2. vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia)*”, andaj duke u bazuar në dispozitën ligjore të sipërcituar kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi për përmbarim është lëshuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe i përmban të gjitha elementet e përcaktuara me këto dispozita andaj nuk ekziston asnjë shkak që kjo Gjykatë të mos e përkrah vendimin e gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm.

Lidhur me pretendimin e debitorit se kreditori ende pa përfunduar procedura e ankimit ka parashtruar propozim për përmbarim të vendimit të inspektoratit të punës, as ky pretendim nuk qëndron e kjo për faktin se përmbarimi është caktuar pikërisht në bazë të vendimit të dhënë në procedurë administrative, i cili përmban klauzolën se “*ankesa e ushtruar në Vendimin e Inspektorit të Punës nuk e shtyn ekzekutimin*” duke qenë kështu në harmoni të plotë me dispozitën e nenit 6.4 i Ligjit për Inspektoratin e Punës i cili përcakton se: “*Ankesa e ushtruar në vendimin*

e Inspektorit të punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.” Andaj, në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim të dhënë në procedurë administrative i cili vendim është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, kështu që nuk ekziston asnjë pengesë ligjore që vendimi në fjalë të mos përmbahet.

Nuk qëndrojnë pretendimet për mosplotësimin e kushteve për lejimin e përmbarimit dhe as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata në procedurë përmbarimore e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbarimor, vlerëson nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktvendimit përmbarimor dhe në procedurën sipas prapësimit gjykata i vlerëson shkaqet e treguara në prapësim nga neni 71 i LPP-së. E rëndësishme është që gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht edhe gjykata ankimore të vlerësojë nëse janë plotësuar kushtet për lejimin e përmbarimit sipas kushteve që kërkohen për lejimin e përmbarimit sipas dokumentit përkatës përmbarimor, ashtu që në këtë rast janë plotësuar të gjitha kushtet për lejimin dhe zbatimin e përmbarimit.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit kur ka theksuar se kreditori për të njëjtën çështje ka paraqitur edhe më parë propozim për përmbarim dhe se në këtë kontest kanë përfunduar të gjitha procedurat gjyqësore ngase në rastin konkret nga provat e bashkangjitura krahas ankesës konstatohet se kemi të bëjmë më çështje tjetër pasi që më parë propozimi për përmbarim ishte ushtruar përmes dokumentit përmbarimor dhe atë vendimit administrativ, Vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94, të datës 10.01.2020 derisa propozimi për përmbarim në rastin konkret është iniciuar përmes Vendimit 01 Nr.21-65, të datës 16.03.2021. Po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të përmbarimit se propozimi për përmbarim i kreditori është i pasafatshëm, ngase Gjykata e Apelit vlerëson se dokumenti përmbarues në bazë të cilit është caktuar përmbarimi është nxjerrë në kohën sa ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale, andaj pretendimet e tilla u refuzuan si të pathemelta.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitivin e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *“në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
C.A.P.nr.774/2023, më datë 20.02.2024

Gjyqtari,
Besnik Bislimaj, d.v